



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.803/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Luljeta Ahmetaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Deçan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 11.11.2017, mori këtë,

## V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i Luljeta Ahmetaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Deçan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me shenjën ZL.Anr.803/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.803/2017 me datën 09.11.2017 në ora 19:30, nga parashtruesja Luljeta Ahmetaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Deçan, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendohet se votat e dërguara përmes postës nga e bija e kandidates në fjalë nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtar të publikuara nga KQZ.

Parashtruesja e apelit si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimit në apel gjeti se parashtruesja e apelit me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar se 10 votat e dërguara përmes postës i mungojnë, dhe në cilat vendvotime pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.803/2017 më datën 11.11.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Dr.sc. Rafet Haxhaj**



### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*